# DËSHMI ARKIVI

**A-473061**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Gavin Bazunu nuk do të luajë ndaj Izraelit për arsye parimore |
| ADRESA | `https://albeu.com/sport/gavin-bazunu-nuk-do-te-luaje-ndaj-izraelit-per-arsye-parimore/1029174/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 07:40:48 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 07:39:15 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d7c92f78338ed45be67a3f355953811642b327025c64fbfaf1c8fd2e3ca42eb0` |
| TEKSTI | `86033aa3ba90ac05ef17ca0b3e3aaa5203a693c47c4a0ec1ab6c5b618b163eed` |
| PAMJA | `d4a5a921786485adbd0794509da212ad0a7b4c16de144a05c4c8d259ba413e8e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e0fa58e629699924defaeda39818e7a1db7fe6f11eeff2ce75b432b9feec5cc4` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `ffa3671555d7ae6cb03bad74ec6398ad3819e03f2270ea6128c9f6d225eb63a8` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e0fa58e629699924defaeda39818e7a1db7fe6f11eeff2ce75b432b9feec5cc4`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Gavin Bazunu nuk do të luajë ndaj Izraelit për arsye parimore




Gavin Bazunu ka bërë të ditur se nuk do të jetë pjesë e Republikës së Irlandës në dy ndeshjet e fazës së grupeve të Ligës së Kombeve kundër Izraelit, duke e lidhur këtë vendim me bindjet e tij personale.

Përmes një postimi në Instagram, portieri 24-vjeçar shpjegoi se zgjedhja e tij nuk drejtohet kundër popullit izraelit apo komunitetit hebre, por lidhet me një çështje parimore.

Bazunu tha se përfaqësimi i Irlandës ka një rëndësi të veçantë për të dhe shprehu respektin e tij për bashkëlojtarët, trajnerin, stafin teknik dhe popullin irlandez.

Megjithatë, ai pranoi se vendimi për të mos luajtur nuk ka qenë i lehtë. Portieri u shpreh se është një person thellësisht fetar dhe se përpiqet të udhëhiqet nga karakteri dhe parimet e tij.

“Për këtë arsye, besoj se do të ishte e gabuar për mua të marr pjesë në ndeshjet e ardhshme kundër Izraelit”, shkroi ai.

Sipas Bazunut, qëndrimi i tij bazohet vetëm në bindjen se vrasja e njerëzve të pafajshëm është e gabuar. Ai theksoi se nuk është kundër popullit të Izraelit dhe as komunitetit hebre, por kundërshton mizoritë që po ndodhin në atë rajon.

“Në jetë nuk janë të shumta rastet kur mund të qëndrosh për diçka më të madhe se vetja. Unë besoj fort se ky është një prej atyre momenteve”, shtoi portieri irlandez.

Përballja e parë mes Izraelit dhe Republikës së Irlandës do të zhvillohet të dielën, më 27 shtator, në Debrecen të Hungarisë.

Ndeshja e dytë është programuar për 4 tetor në Baçka Topola të Serbisë. Të dyja takimet do të luhen në fusha neutrale.

të fundit/


Pas gati 30 vitesh, Gjykata e Lartë lejon rikthimin e marshimit …


Gavin Bazunu nuk do të luajë ndaj Izraelit për arsye parimore


Operacion kundër grupeve që shisnin lëndë narkotike pranë…


Nëntë të arrestuar në Zubin Potok për dyshime për krime luf…


Mërgata proteston për drejtësi ndaj çlirimtarëve, Prishtina…


Shpërthen bombola e gazit në Pojan të Maliqit, 74-vjeçari digj…


Bukova, deponia që vijon të shqetësojë banorët dhe turistët e…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Trajneri i Irlandës, Heimir Hallgrimsson, kishte deklaruar më herët se në skuadër ka mendime të ndryshme për këto ndeshje dhe se disa lojtarë ndihen të parehatshëm për shkak të situatës rreth tyre.

Që nga debutimi në vitin 2021, Bazunu ka zhvilluar 22 ndeshje me fanellën e Republikës së Irlandës në të gjitha garat.

Shtuar më 27.09.2026 09:39

Tags: Gavin bazunu , Kombëtarja e irlandës , Liga e Kombeve , Përfaqësuesja e izraelit



Olise synon La Ligën si destinacionin e tij të ardhshëm




Analiza e Maran pas fitores: U futëm 20 herë në zonë, Shqipëria dallohej…



Hallgrimsson korrigjon deklaratën për "gjenocidin" para përballjes me Izraelin



Kosova synon rezultat pozitiv në transfertën ndaj Austrisë




Austri–Kosovë në Vjenë: Të gjitha zhvillimet, minutë pas minute



Pas 30 vitesh njohje, Foda dhe Rangnick përballen për herë të parë si trajnerë




Maran feston debutimin fitues me Shqipërinë: Një nisje më të mirë nuk mun…



Uzuni pas fitores me Bjellorusinë: Për Kombëtaren luaj në çdo…

© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko... Kërko

**Kryesore**
- Erion Veliaj
- Free Esim
- Zgjedhjet 2025
- Belinda Balluku
- SPAK
- Kombëtarja

**Kategori**
- Lifestyle
- Showbiz
- Tech
- Shëndetësi
- Argetim
- Enciklopedi

**Linqet**
- Live tv shqiptare
- Moti në Shqipëri
- Travel
- Horoskopi
- Livescore
- News from Albania

**Tags**
- Edi Rama
- Albania News
- Ilir Meta
- Piranjat
- gazeta, tv, portale
- Sali Berisha

**Moti**
- Moti në Tiranë
- Moti në Prishtinë
- Moti në Shkup
- Moti në Durrës
- Moti në Prizren
- Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.